



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QY CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
01	12669
Ar. i faq.	Data:
02	23/05/2025
Ar. str.	Datum:
	Kamenica Municipality
KAMENICË/A	



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 23.05.2025

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 23.05.2025 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e V-të (të rregullt) të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **30.05.2025**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e IV-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025.
2. Pyetje legjislativitet drejtuar ekzekutivit.
3. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Kamenicë për vitin 2025-2027.
4. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Bratilloç, me nr. P- 71107008-000-25-0.
5. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale, për parcelën me nr. P- 71107008-000-25-0.
6. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për zonën kadastrale në Kamenicë, me nr. P - 71107041-01981-0.
7. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale, për parcelën me nr. P- 71107041-01981-0.
8. Propozim-Vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Ndërtimi i varrezave në fshatin Hodonoc” në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Këshillit Lokal të Fshatit Hodonoc.
9. Propozim-Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik nën menaxhim të AKP-së me nr. P-71107041-01157-2.
10. Propozim-Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Solar Green Energy SH.P.K”, me procedurë të negocimit të ofertës.

11. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0.
12. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale, për parcelën me nr. P-71107041-01336-1, P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0, P-71107041-01335-0.
13. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0.
14. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale, për parcelën me nr. P-71107079-00558-2 dhe P-71107079-00308-0.
15. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik për parcelat me nr. P-71107074-00868-0, 03101-0, 00022-0, 00816-0, 00816-0.
16. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale, për parcelën me nr. P-71107074-00868-0, 03101-0, 00022-0, 00816-0, 00816-0.
17. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Veton Kallaba B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës.
18. Propozim-Vendim për formimin e komisionit të ankesave.
19. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8623 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike.
20. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8628, i VSM e Planeve Nderkomunale për menaxhimin e Integruar të mbeturinave për Komunitet të Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë – Kosovë.
21. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit me nr.8627 i i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit.
22. Të ndryshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRABANA

Sh. 01 Nr. 12642
U. Br.
Nr. i faq. 7 Data: 23/05
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2025

PROCESVERBAL

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Nga mbledhja e IV-të e Kuvendit të Komunës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më: 30.04.2025 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës së Kamenicës, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, , përfaqësues nga zyra për integritet evropiane, zyra e informimit dhe OSBE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e III-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,
2. Pyetje të legjislativ të drejtuar ekzekutiv,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Janar-31 Mars 2025,
4. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Draft Rregullores për Themelimin dhe Punën e Asamblesë Komunale të fëmijëve në Komunë e Kamenicës,
5. Draft Rregullore për Transparencën e Komunës së Kamenicës,
6. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Veprimit për Transparencë periudha 2025-2029,
7. Shqyrtimi i Raportit Monitorimi dhe Zbatimin e Planit të Integritetit për periudhën Korrik-Dhjetor 2024,
8. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komuniteti lokal në fshatin Muçivërc,
9. Propozim-Vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2024 në vitin 2025,
10. Propozim-Vendim për rialokime dhe transfere,
11. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-fillimisht konstatojmë se kemi kuorum për ta filluar këtë mbledhje. A keni propozime për rend dite, nëse nuk keni vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e III-të e Kuvendit Komunal për vitin 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- jemi në pikën e parë të rendit të ditës, a keni vërejte rreth procesverbalit, nëse nuk keni vazhdojmë me procedurën e votimit?

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

2. Pyetje të legjislativit drejtuar ekzekutivit,

Jeton Biqkaj-edhe në mbledhjen e komitetit ka qenë një kërkesë për regjistraturat e punëtorëve arsimor të shkollave në gjuhën serbe, po ashtu ne e kemi plotësuar kërkesën edhe për regjistrat në gjuhën shqipe. Kjo ka qenë kërkesë e koleges Jadranka dhe që asnjëherë deri më tani nuk është raportuar nga drejtoria e arsimit. Ka raste që janë në listë të pagave por që nuk vijnë mësimin. Kjo kërkesë ka qenë e kuvendit e jo e një delegati të caktuar.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- kjo kërkesë është bërë edhe nga Komiteti për Politikë dhe Financa por deri më tani nuk kemi pranuar asnjë informatë.

Rabit Dërmaku-unë kam bërë një pyetje rreth pagesës së Këshillave Lokale, a është marrë ndonjë iniciativë rreth këshillave Lokale ?

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës, edhe unë jam i interesuar për me i paguar unë do të propozoja që të merret një vendim nga kuvendi por të shikohet edhe ligjshmëria e vendimit. Ose e ndërpresim tani për pak minuta seancën dhe e shënojmë propozim-vendimin ose për seancën e ardhme të jetë pikë e rendit të ditës.

Jadranka Nikolić- regjistrat nuk janë dorëzuar që katër muaj, na bazë të çfarë vendimi iu është lëshuar deri më 31 Janar këto regjistra a është e mundur që të jenë aq mistik. Pyetje për kryetarin, katër infermiere janë larguar nga vendi i punës ato urdhnesa a janë në bazë të ligjit apo jo? Për këtë mandat që jeni duke udhëhequr për çfarë arsye nuk e keni parë të arsyeshme që të prezantojë përfaqësuesen e komunitetit jo shumicë në seancat e kuvendit ?

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-sa i përket së KPF-së do ta trajtojmë në seancën e muajit maj.

Sejdi Kurteshi-një padi që e keni bërë kinse për shpifje Gjykata Themelore e Gjilanit, dega në Kamenicëse ka hedhën poshtë të pabazuar ankesën e juaj.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Janar-31 Mars 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- jemi në pikën e tretë të rendit të ditës, fjalën e kalojmë tek z. Naser Hashani.

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar, Raporti i tremujorit të parë buxhetor, për periudhën Janar-Mars 2025, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L —048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Performanca e të hyrave, Si rezultat, gjithsejtë të hyrat vetanake të Komunës gjatë tremujorit të parë kanë shënuar shumën prej **202,936.12 C** apo 33.39% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja ka qenë kryesisht nga të hyrat: Tatimi ne Pronë dhe disa të hyra të tjera të cilat janë të shpalosura në tabelë më poshtë. Të hyrat tatimore kanë shënuar një rritje prej **20,793.95 €** më shumë krahasuar me tremujorin e vitit paraprak apo shprehur ne % 44.56%. Të

hyrat jo tatimore kanë shënuar një rritje krahasuar me vitit paraprak për periudhën tremujore të fundit prej 28.91% që korrespondon me 30,384.30€. Të hyrat e inkasuar për periudhën Janar-Mars janë realizuar prej 19.96% nga të hyrat e gjithmbarshme. Performanca e shpenzimeve. Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 3,647,933.95 € përgjatë tremujorit të parë të vitit 2025, apo 6.53% më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak. Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën 2,298,906.93 , duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 25.03% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Krahasuar me vitin 2024 kanë shënuar një zvogëlim prej 26.56%. ky zvogëlim është për shkak të ekzekutimit të gjykatës gjatë tre mujorit të parë të vitit të kaluar. Shpenzimet në mallra dhe shërbime kanë shënuar një rritje prej 262.19% krahasuar me vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2025 vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur 554,200.69 f, kjo shumë korrespondon me 22.87% të buxhetit të tërësishëm për këtë kategori .Rritja e kësaj Kategorie krahasuar me vitin 2024 ka rrjedhë për shkak të ekzekutimit të aktvendimeve të gjykatës ne shume prej 286,380.83 €. Shpenzime në komunal, kanë shënuar një zvogëlim të prej 0.10% krahasuar me vitin 2024. Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars 2025 vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur në: 61,763.88 të buxhetit për këtë kategori për këtë periudhë kjo shumë korrespondon me 23.57%Zotë buxhetit të tërësishëm për këtë kategori. Shpenzimet në subvencione dhe transfere, shënuan rritje prej 262.40% gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 32.48% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Rritja e kësaj kategorie krahasuar me vitin 2024 ka rrjedhë për shkak të ekzekutimit të aktvendimeve të gjykatës ne shume prej 212,156.60 €. Shpenzimet kapitale, shënuan rritje prej 6.53% € gjatë këtij tremujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 17.51% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë. Rritja e kësaj Kategorie krahasuar me vitin 2024 ka rrjedhë për shkak të ekzekutimit të aktvendimeve të gjykatës ne shume prej 431,160.76 €. Nëse keni pyetje unë jam këtu dhe mund të ju përgjigjem. **Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-** a keni pyetje të tjera, nëse nuk keni kalojmë në pikën e 4-të,

4. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Draft Rregullores për Themelimin dhe Punën e Asamblesë Komunale të fëmijëve në Komunë e Kamenicës,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, për këtë pikë ja kalojmë fjalën znj. Nazmije Demolli.

Nazmije Demolli-Koordinatorë për të Drejtat e Fëmijëve, kjo rregullore për qëllim ka për edukimin e fëmijëve në proceset vendimmarrëse, avancimin e të drejtave të tyre. Asambleja ju mungon fëmijëve që të shprehin mendime dhe propozimet për çështjet që lidhen me shkollën, realisht asamblenë e fëmijëve ne e kemi formuar nga viti 2022 është funksionale mbahen takime të rregullta, por kur e kemi edhe këtë rregullore kjo vetëm sa në forcon më shumë edhe ligjërisht. Si komunë e kemi obligim që ta kemi një rregullore të tillë, nëse keni pyetje unë jam këtu që të ju përgjigjem.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni pyetje për këtë pikë të rendit të ditës, nëse nuk keni vazhdojmë me procedurë të votimit

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....Të gjithë

Kundër.....0

Abstenim.....0

5. Draft Rregullore për Transparencën e Komunës së Kamenicës,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-është kërkesë që secila komunë të ketë një rregullore të tillë që do të ndikojë në transparencën komunale dhe

efikasitetin e saj. Sa i përket kësaj draft rregullore janë konsumuar të gjitha obligimet ligjore, si debatin publik, njoftimet e tjera të nevojshme. A e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....18

Kundër.....0

Abstenim.....2

6. Shqyrtimi dhe Aprovimi i Planit të Veprimit për transparencë periudha 2025-2029,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, i njëjti plan ka të bëjë me rregulloren përkatëse që e diskutuam më lart, ky është edhe njëri nga aspektet ligjore të cilin raport e përmbush nga kërkesat që vinë nga MAPL, A e dëshiron dikush fjalën, nëse jo e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....18

Kundër.....0

Abstenim.....2

7. Shqyrtimi i Raportit Monitorimi dhe Zbatimin e Planit të Integritetit për periudhën Korrik-Dhjetor 2024,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës, jemi në pikën e shtatë të rendit të ditës fjalën ja kalojmë z. Zijadin Thaqi,

Zijadin Thaqi, Shef i Zyrës për Integritete Evropiane, e kemi edhe obligim ligjor që në kuvend të jetë si informatë. Ky plan i ndihmon autoriteteve lokale të krijojnë një mjedis administrativ më të pastër dhe të besueshëm i cili është në përputhje me standardet më të larta etikës dhe llogaridhënies. Me anë të transparencës, pjesëmarrjes qytetarëve dhe monitorimit të vazhdueshëm mund të arrimë një qeverisje lokale më të mirë. Nëse keni pyetje unë jam këtu për përgjigje.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni pyetje të tjera, nëse jo vazhdojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

8. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komuniteti lokal në fshatin Muçivërc,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-kemi edhe anëtarë të këshillit lokal ka të bëjë me kërkesën e caktimit të një lokacioni për ndërtimin e një objekti për nevoja të ndryshme të fshatit. A e dëshiron dikush fjalën, nëse nuk keni diskutime e hedhim në votim.

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....21

Kundër.....0

Abstenim.....0

9. Propozim-Vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2024 në vitin 2025,

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës-jemi në pikën e 9-të, fjalën e kalojmë tek z. Naser Hashani.

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar-kërkesa për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake tejkaluar 2024-2025, për vitin 2024 të gjitha të hyrat që janë inkasuar 966 mijë 825.90€, ndërsa pjesa që duhet të bartet është 408 mijë 555.27 dhe në bazë të raportit të sistemit që i kemi mjetet e tepruara i kemi specifikuar në kategorinë e mallra dhe shërbime dhe në kategorinë për investime kapitale. Pjesa që do të barten në kategorinë për mallra dhe shërbime për mos me ndryshuar strukturën e kategorive ekonomike është 31,701.95€, ndërsa kategoria për investime kapitale është pjesa e mbetur 376,853.32€ ku i kemi specifikuar në programe dhe nën programe, me kërkesën tonë që i keni para vete. Gjitha këto shpërndarje të mjeteve që janë bërë janë edhe arsyeshmëria se ashtu kërkohet edhe nga ministria që të jenë me dokumentacion përkatës të përcillet.

Labinot Haxhiu-këto 376,853.32€ që kanë qenë të parapamë për investime kapitale, cilat janë arsyet që s'kanë pas mundësi që të shpenzohen vitin e kaluar, ngase i bie diku 40% e buxhetit që nuk ka arritur me u shpenzuar.

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar-gjithë faktorët kanë edhe arsyeshmërinë po e sqaroj bartja e të hyrave 2024, tek participimi 64 mijë euro me donator është obligim i vitit 2024, tjetra është çështja e ndërtimit të "Lugut të Verdhë" si ritenderim 192 mijë 562.20€, në vitin 2024 janë ekzekutuar vetëm 34 mijë 250 euro, ndërsa pjesa e mbetur në kontratë do të ekzekutohet në shumë prej 64 mijë euro, nga buxheti i vitit 2025 dhe i njëjti kod i projektit që e kemi të dedikuar për vitin 2025. Projektet janë që nuk kanë përfunduar në vitin 2024 edhe për shkak të kohës por edhe për shkak të operatorit që ka pasur obligime.

Labinot Haxhiu-ne kemi pas edhe një kërkesë nga sindikata e cila si pasojë e mos pajtueshmërisë tonë e ka bërë të pamundur me vazhduar seancën. Unë e di se raportin që e kemi pasur diku rreth 800 mijë euro kanë tepruar nga buxheti i Kamenicës e të cilat nuk kanë arritur me u shpenzuar. Cila është arsyeja e 376,853.32€, mos me u shpenzuar nga të hyrat vetanake. Nëse ka mundësi të dimë se sa % jaën kryer të punëve deri më tani tek "Lugu i Verdhë"?

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës, kjo pikë ndodh çdo herë që të hyrat të barten, ngase ashtu e kërkon edhe ministria jo të gjithë buxhetet shfrytëzohen 100%, diku përmbaruesi ta pamundëson me ec në buxhet, ngase në fund vit i kemi pasur diku 3 milion euro me përmbarues, e që është dashur me kryer pagesën në fillim të vitit, parashihet lëvizje të mjeteve në ato kategori që janë të shpallura e në ato që janë të pashpallura edhe nëse kemi thënë shembull që do të kryhet një punë, mjetet do të shkojnë diku tjetër që është lidhur kontrata. Një prej arsyeve është edhe shqyrtimi i ligjshmërisë së landëve.

Labinot Haxhiu- sa janë paguar nga Komuna e Kamenicës nga fillimi për "Lugun e Verdhë"?

Me tepruar 35% e buxhetit për mua është alarmante.

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës- edhe ne kemi qejf me ecë projektet dhe me u realizuar, por kur pamundësohet në procedurë me ecën para është që duhet të presim. "Lugu i Verdhë" është në kontratën e tretë dhe punë po ecin në teren % mund të jetë në disproporcion me punët në teren, mund të ketë më shumë punë në teren se sa pagesa.

Labinot Haxhiu- vet fakti që në grand të performancës është nominuar mbi 75 % të shpenzimeve për investime kapitale është keq menaxhimi që ju nuk arrini me i shpenzuar ato mjete. Mjetet janë kthyer mbrapa si tepricë me u kthyer 35 % e buxhetit është keq menaxhim.

Ramadan Basha-për mua është krejt normale bartja e mjeteve prej një viti në vitin tjetër për shkak se mjetet teprojnë dhe projektet nuk realizohen për shkak të shumë specifikave. Për mua nuk kam çka të bëjë një pyetje kur sqarimet janë të plota, të thukta dhe kredibile, kur unë e kuptoj procesin, ka gjasa se ndonjëri nga asambleistët nuk ka qenë në atë mbledhje.

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar- sa i përket "Lugut të Verdhë" kemi kompani të ndryshme, për operatorët ekonomik janë paguar vetëm 34 mijë 250 €.

Jeton Biqkaj-për mua keq menaxhimi është kur i ke paret dhe nuk i shfrytëzon, pengesat që janë është çështje tjetër e kemi projektin e shkollës “ Fan S Noli” qe katër vite nuk është bërë asgjë, pastaj projekti i sheshit qe katër vite nuk është bërë asgjë, projektin e “ Lugut të Verdhë” i cili nuk ka përfunduar. Pse lejohet kontraktori që të zvarrit kaq shumë punët në teren, mendoj se afatin e parë pasi që mendoj se ka mekanizma ligjor dhe në kontratë qëndrohet strikt se kur do të fillojë puna dhe kur do të përfundojë, mendoj se nuk mund të ketë këto pengesa e vonesa.

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës-për mua keq menaxhim është kur i ke mjetet dhe nuk i fut në procedurë. Janë 150 procedura të prokurimit të zhvilluara për me i krahasuar më herët është 4-fishi, kur ke procedura më shumë ka edhe pengesa më shumë nga operatorët e njerëzit e interesit. Janë zotuar të gjitha mjete këtë mund të ju argumentoj kur të duash që ne po dëshirojmë me i shpenzuar të gjitha këto mjete, pavarësisht procedurave administrative që dikush e mohon. Nëse nuk gaboje në muajin gusht e kemi marrë edhe një vendim për rialokim të mjeteve për të cilën ministria e financave nuk ka kthyer mendim për ligjshmëri dhe kemi shkuar 3 herë në ministri dhe në zyre të auditorit të përgjithshëm, ku jemi takuar ku e kanë pranuar se vendimi i komunës është i ligjshëm. Këtu e kanë dëshmuar që mjetet e Kamenicës kanë pasën drejt me u shpenzuar, por këtë s'kanë pas drejt me i ekzekutuar. Nuk mund të thuhet keq menaxhim, kur këtu është tejkalim. Nëse është keq menaxhim si po arrimë ne me marrë të hyra më shumë se sa që kemi projektuar. Edhe për sheshin edhe për shkollën unë mund të ju sjell edhe raport të detajuar unë ju them se “ Fan S Noli “ e ka pasën një kontratë që e ka shkëput dhe është nisur një procedurë e re gjithmonë të udhëhequr nga Ministria e Arsimit, është shkëput kontrata, është lidh kontrata e dytë ka përfunduar në OSHP, kemi priten deri më tani dhe tani kemi lidhën kontratë në vlerë prej 2.8 milion euro. Njëjtë është me sheshin kontrata e parë është shkëput se operatori nuk ka dasht me kryer punën, si komunë kemi marrë hapat me lidh kontratën e dytë operatori ka punuar vetëm pemët nuk ka punuar më shumë dhe asnjë afatet ligjore që duhet me rrjedh për me shkëputur kontratën. Një kontratë në vlerë prej 500 mijë euro qëndron në prokurim 40 ditë edhe 30 ditë të tjera me vlerësuar 70 ditë ai e ka planin për realizimin e projektit dhe ne duhet të presim nëse enuk e e realizon marrim masa të tjera e shkëpusim kontratën, prapa fillojmë procedurën dhe prej shtatorit të vitit të kaluar ajo është në OSHP me sheshin. Para dy jave e kemi nënshkruar kontratën për sheshin edhe qejfi i jem është që të përfundojnë punët në teren. Ligji për procedura administrative çdo shkresë duhet të merr përgjigje brenda 30 ditëve, këtu ka 8-9 muaj ne nuk marrim përgjigje. Kur të doni ne mund të thërrasim interpelancë edhe për cilin do projekt që ju dëshironi, ku do të marrin pjesë edhe operatori i punëve por edhe menaxheri i kontratës.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni diskutime të tjera, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....19

Kundër.....0

Abstenim.....3

10. Propozim-Vendim për rialokim dhe transfere,

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar-kjo është një kërkesë edhe për transfer edhe për rialokim. Kjo është e bazuar me ligj të buxhetit për vitin 2025, neni 15, pika 11 dhe 12 dhe neni 16 pika 11 e Ligjit Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore. Rialokimi është ku i njëjti program për investime kapitale në shuma të caktuara mund të rialokohen komplet shuma në ato projekte, kurse çështja e transfereve është pak më ndryshe në këtë rast çështjen e transfereve e kemi tek rezervat, përjashton ligjin në ato % deri në 15% -ministri, 15-25% kryeministri dhe mbi 25% Kuvendi i Kosovës. Këto rezerva i kanë trajtuar si rezerva, ka qenë edhe një pajisje bujtore që është dashur të blehet me drejtorinë për bujqësi dhe këtë e kanë trajtuar më tepër si subvencion e jo si investim kapital këtë pjesën e rezervave e kemi tek shuma e transfereve. Në projekt që merren mjetet për rialokim janë projekte që nuk janë iniciuar aktivitet e prokurimit, implikimet buxhetore nga ekzekutimi i

vendimeve gjyqësore të komunës që është imponuar të anulohet disa nga projektet dhe të orientohen tek projektet me kontrata aktive dhe memorandum mirëkuptimi për financimin e projekteve infrastrukturore që ka nënshkruar kryetari me ministrinë e mjedisit.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, memorandumin e fundit që e kemi nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit është vlera 2.6 milion euro aty janë të përfshira disa fshatrat si: Muçivërcë, Topanicë, Kamenica, Berivojca. Ku kemi disa projekte që i realizojmë me kontratën aktuale e për mi rialokuar mjetet në projekte të reja e kemi bërë këtë vendim, ndërsa pjesën tjetër me ministrinë është një ndarje e buxheteve që neve që neve në komuna na kanë krijuar një komoditet për rialokim të projekteve. Jemi detyruar që edhe për shkak të përmbarimeve ku ka marrë mjete edhe nga kategoria e investimeve kapitale.

Naser Hashani-Zyrtar Kryesor Financiar- janë të parapamë edhe në raport cilat projekte janë marrë 300 mijë euro që janë marrë në projekte të caktuara. Kemi dashur të bëjmë një zgjidhje që projektet të cilat janë me kontratë aktive mi marrë me i rialokuar në ato projekte që kanë kontratë dhe që nuk kanë procedura të prokurimit.

Labinot Haxhiu- unë ju dëgjova që ka projekte që nuk janë iniciuar procedura të prokurimit, **Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës**- ka projekte që nuk janë iniciuar procedura të prokurimit, nëse nuk gaboj është QKMF që ka me ndërtuar që do të ndërtohet lifti edhe shtëpitë e kulturës. Në shtëpi të kulturës e ka realizuar liftin Ministria e Kulturës, ndërsa nuk ka filluar ende. Është edhe blerja e makinerisë së qumështit e cila ka shkuar në rezerv që nuk kanë filluar procedura dhe me patjetër me bartën mjetet tek një kod që do të shfrytëzohen mjetet për ndryshe mjetet shkojnë në suficit. Digjitalizimi komunal nuk ka filluar për shkak të që kemi një marrëveshje me universitetin Kadri Zeka të cilët kanë shprehur gatishmërinë ata me realizuar. Ndërtimi i trotuareve në Kamenicë nuk ka filluar ngase hyn në kuadër të asfaltimit me marrëveshjen që e kemi nënshkruar me ministrinë.

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- a keni diskutime të tjera, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për.....18

Kundër.....0

Abstenim.....3

11. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Kuvendit Komunal të Kamenicës- tek pika në të ndryshme a e dëshiron dikush fjalën nëse jo me kaq e përmbyllim seancën.
Mbledhja përfundon në ora 11:00

Procesmbajtëse


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Municipality of Kamenicë

PLANI I PUNËS
PËR
EKIPIN KOMUNAL PËR TË DREJTAT E
FËMIJËS, KAMENICË
(2025 – 2027)

Kamenicë, Mars 2025

Përmbajtja

PARATHËNIE	3
HYRJE	3
KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL	5
PARIMET DHE VLERAT	6
QËLLIMI JONË	7
FUSHAT E VEPRIMIT	7
OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMIT	8
OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë	8
OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve.....	11
OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët	13
OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit	13
OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre	15
OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë..	16
PLANI I VEPRIMIT	17
SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT	23

PARATHËNIE

FJALA E KRYETARIT

Të nderuar përfaqësues institucional, bashkëpunëtorë dhe qytetarë të komunës sonë,

Komuna e Kamenicës mbetet e përkushtuar që të ndërtojë politika të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve. Të udhëhequr nga parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si dhe nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës, ne kemi ndërmarrë hapa konkret në funksionalizimin e mekanizmave të nevojshëm për këtë qëllim.

Hartimi i këtij dokumenti është një hap i rëndësishëm në drejtim të fuqizimit të rolit të institucioneve vendore në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përfshirjen e tyre aktive në vendimarrje, përmes themelimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve dhe Planit të Punës për periudhën 2025–2027.

Ky proces është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë fëmijët, dhe paraqet një praktikë të mirë të qeverisjes së hapur dhe gjithëpërfshirëse në nivel lokal. Falënderoj të gjithë zyrtarët komunalë, partnerët dhe kontribuuesit që kanë dhënë mbështetjen e tyre në hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Kamenicës do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ndërtimin e një mjedisi ku çdo fëmijë të ketë mundësinë të zhvillohet, të mbrohet dhe të dëgjohet.

Sinqerisht,

Kadri Rahimaj - Kryetar i Komunës së Kamenicës

HYRJE

Komuna e Kamenicës në kuadër të politikave zhvillimore për të përmirësuar jetën e qytetarëve të saj, rendësi shumë të veçantë i kushton investimin në fëmijë dhe në interesin me të mirë të tyre, konform obligimeve ligjore, Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës¹, Udhëzimin Administrativ (QRK) 06/2020 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës² dhe Profili i Komunave të Kosovës, MAPL, 2021³.

Përmes këtij plani të punës ne si komunë zotohemi dhe do të angazhohemi vazhdimisht në garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive, shëndetësi dhe arsimi cilësor. Marrjen e masave për t'i siguruar secili fëmijë në komunën tonë ushtrimin e të drejtave në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive, bazuar gjithnjë në interesin më të mirë të tyre.

Zhvillimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel lokal, si dhe organizatave për mbrojtjen e fëmijës, prindërit dhe vetë strukturat fëmijëve, këshillat e nxënësve apo asamblenë e fëmijëve dhe mekanizmat përgjegjës në nivel nacional.

Si Komunë ne jemi të përcaktuar të angazhohemi në vazhdimësi në parandalimin e hershëm të dhunës dhe dukurive të tjera, mbrojtjen dhe ofrimin e kushteve dhe mundësie që fëmijët e komunës sonë të gëzojnë të drejtat që ju garantohen me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës, (2021)⁴ në ofrimin e kushteve për zhvillim të plotë të tyre. Ky përcaktim, reflektohet në politikën tonë qeverisëse e cila është miqësore për ta, që komuna e Kamenicës të jetë komunë miqësore për të gjithë fëmijët.

Plani i punës trevjeçar (2025-2027) do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, si një mekanizëm gjithëpërfshirës i themeluar së voni nga komuna për të hartuar politika praktike në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Plani i punës është hartuar në përputhje me praktikën e promovuar të qyteteve mike për fëmijë dhe përmban fusha të ndryshme të veprimit, të nevojshme për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e tyre kudo.

Procesi i hartimit të këtij plani ka qenë një proces dinamik me pjesëmarrje të gjerë, përfshirë sektorët komunalë në konsultim me institucionet qendrore Ministrinë e Administrimit Lokal, Zyrës për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, organizatat lokale që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve - Syri i Vizionit, NOPM, Proaktiv, si dhe vetë fëmijët përfaqësuar nga këshilli i nxënësve/asambleja e fëmijëve dhe kryetarin e këshillit të prindërve në cilësinë e vëzhguesit në kuadër të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Disa nga veprimet që i kanë paraprirë hartimit të kësaj strategjie janë:

- Organizimi i konsultimeve paraprake me palë të ndryshme që kanë ndihmuar në mbledhjen e informatave themelore dhe përgatitjen e procesit të planifikimit;
- Punëtori njëditorë e planifikimit me pjesëmarrje të anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve, ku janë identifikuar fushat e veprimit, si dhe është përcaktuar logjika e intervenimit;

¹ <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

² <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=81556>

³ <https://mapl.rks-gov.net/Vep-content/uploads/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>

⁴ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_21_1226

I gjithë procesi është udhëhequr nga Kryesuesi i Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, njëherit kryetari i komunës së Kamenicës z. Kadri Rahimaj mbështetur nga sekretaria e Ekipit prër të Drejtat e Fëmijës znj. Nazmije Demolli Kastrati, Kondinatore për të Drejtat e Njeriut, ndërsa përkrahje profesionale është ofruar nga MAPL-ja z. Ejup Kamberaj dhe znj. Luljeta Ibishi Ferizi, Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Njeriut në Komunë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe z. Naser Lajqi, udhëheqës i programeve për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës nga organizata Syri i Vizionit.

KONTEKSTI GLOBAL, NACIONAL E LOKAL

Pa dyshim se Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës⁵ është bazamenti i secilit veprim në fushën e të drejtave të fëmijëve. Parimet e saj janë të përqafuara në politika ndërkombëtare që prekin jetën e fëmijëve, por edhe në politikat vendore e lokale. Detyrimisht, edhe ky plan i punës është ndërtuar mbi parimet udhëheqëse të Konventës.

Në nivel vendi veprimi për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës është planifikuar përmes strategjive. Kështu, sikurse strategjitë pararendëse, edhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijës 2019 – 2023⁶ përcakton obligimin e autoriteteve në nivelin vendor dhe lokal për qeverisje që mundëson realizimin e të drejtave të fëmijëve. Objektivi i dytë strategjik në këtë strategji kërkon që qeverisja lokale t'i prioritetizojë të drejtat e fëmijëve, duke synuar përmirësimin e jetës së fëmijëve brenda juridiksionit të tyre në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe korniza ligjore vendore.

Kosova për herë të parë më 17 korrik të vitit 2019 ka miratuar Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës⁷, duke hapur rrugën operacionalizimit të tij përmes akteve nënligjore dhe krijimit e funksionimit të mekanizmave mbrojtës për fëmijët. Kështu ndër të tjera përcakton që Ekipi për të Drejtat e Fëmijës krijohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës në nivel të vendimarrjes politike. Në nenin 20 jepen edhe konturat e fushëveprimit të këtij ekipi. Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë udhëzimin administrativ 06/2022⁸ për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, që përcakton mënyrën e themelimit dhe aspektet e funksionimit të këtij ekipi.

Në nivelin lokal, Komuna tashmë e ka një përvojë me politika e dokumente që janë të përqendruara në të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës.

Kryetari i Komunës, në përputhje me UA 06/2022, më 03.03.2023 ka nxjerrë vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës. Mbledhja konstitutive për themelimin e Ekipit është mbajtur me datë 21.09.2023.

Ky plan trevjeçar i punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar në përputhje me parimet e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, me politikat e nivelit qendror e lokal, si dhe me konceptin e komunave mike për fëmijë.

⁵ <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

⁶ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Alb-Track-Changes-Strategjia-per-te-drejtat-e-femijeve-FINAL-12032019.pdf>

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

PARIMET DHE VLERAT

Komuna e Kamenicës njihet si institucion model i qeverisjes lokale që u shërben njësoj të gjithë qytetarëve të vet pa dallime, duke u ofruar në të njëjtën kohë mundësi të gjithëve të shprehin potencialin e tyre dhe të kontribuojnë aktivisht në mirëqenien e përgjithshme shoqërore. Një model i këtillë promovohet edhe në raport me fëmijët, ku promovohen dhe realizohen të drejtat e tyre, për arritjen e potencialit të plotë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kushtetutën dhe legjislacionin në Republikën e Kosovës.

Fëmijët do të përfshihen në proceset komunale që lidhen me jetën e tyre dhe duke krijuar kushtet që të zhvillojnë gjithë potencialin e tyre. Si ekip e si komunë, jemi të përcaktuar që proceset në komunë të jenë jo vetëm “për fëmijët” por edhe “me fëmijët”.

Në punën tonë si ekip, udhëhiqemi nga parimet themelore të të drejtave të fëmijëve të cilat janë të përcaktuara në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** - të gjithë fëmijët duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Asnjë fëmijë nuk duhet ta vuaj diskriminimin mbi çfarëdo baze.
- **Interesi më i mirë i fëmijës** - kur merren vendime që ndikojnë fëmijët, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsideratë mbizotëruese.
- **Jeta, mbijetesë dhe zhvillimi** – fëmijës duhet t'i sigurohet mbijetesë dhe zhvillimi deri në masën më të madhe të mundshme. Zhvillimi përfshin edhe dimensionin e cilësisë: jo vetëm shëndeti fizik, por edhe zhvillimi mental, emocional, kognitiv, social dhe kulturor.
- **Pikëpamjet e fëmijës** - fëmijët duhet të jenë të lirë të shfaqin pikëpamjet lidhur me çdo çështje që ndikon në ta dhe këtyre pikëpamjeve duhet t'u jepet peshë e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

Ndërtimi i komunës mike për fëmijë bëhet përmes zhvillimit të **vlerave të përbashkëta**, vlera që ndërlidhen me komunën ku fëmijët:

- Dëgjoen dhe kanë ndikim;
- Janë të mbrojtur nga dhuna e keqtrajtimi dhe ndëshkimi trupor;
- Ndihen të sigurt kudo;
- Luajnë e argëtohen;
- Përfshihen në bazë vullnetare;
- Krijojnë miqësi dhe ndihen të lidhur me komunitetin;
- Kanë mundësi për të mësuar dhe për të zhvilluar shkathtësitë;
- Ndihen të vlerësuar e respektuar;
- Krijojnë ndjenjën e përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve.

QËLLIMI JONË

Qeverisje komunale që siguron mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve, përmes krijimit dhe zhvillimit të një sistemi bashkëveprues të të gjithë sektorëve komunal dhe bashkëpunimit me të gjitha palët.

Ne, do të ofrojmë një model të qeverisjes lokale në të cilën vazhdimisht do të mbizotërojnë interesat më të mira të fëmijës. Përmes bashkëveprimit dhe mirë koordinimit të punëve ndërmjet gjithë sektorëve komunal, do të ofrojmë shërbime shumëdimensionale për fëmijë. Në të gjitha fushat e veprimit do të krijojmë lidhje bashkëpunimi me partnerët dhe komunitetin, që fëmijëve t'u krijojmë një mjedis jetësor të këndshëm dhe mundësues. Rëndësi, vazhdimisht do t'i kushtojmë përfshirjes aktive të vetë fëmijëve në të gjitha proceset vendimmarrëse në komunë që lidhen me jetën dhe interesin me të mirë të tyre. Kështu duke investuar në fëmijë do të ndikojmë që në të ardhmen këta fëmijë do të bëhen qytetarë aktiv dhe të përgjegjshëm.

FUSHAT E VEPRIMIT

Janë identifikuar gjashtë fusha të veprimit në kuadër të planit të punës. Këto fusha, ndonëse janë të veçanta, në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngushtë në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjetrën, duke e bërë planin e punës koherent e gjithëpërfshirës.

1. Shërbimet cilësore e gjithëpërfshirëse për fëmijë

2. Vetëdijësimi dhe avokimi për fëmijë

3. Hapësirat e sigurta e miqësore për fëmijë

4. Sporti, loja dhe rekreacioni për fëmijë

5. Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje

6. Monitorimi, Koordinimi, vlerësimi e raportimi

OBJEKTIVAT, MASAT E VEPRIMET

Këto fusha prioritare, janë përkthyer në objektiva strategjike duke përcaktuar masa që përmbushin realizimin e tyre. Secila masë brenda objektivit përkatës është zbërthyer më tutje në veprime konkrete, që shërbejnë si udhërrëfim në fazën e zbatimit të planit të punës.

OBJEKTIVI 1: Ofrimi i shërbimeve cilësore e gjithëpërfshirëse për fëmijë në komunë

Synojmë përmirësimin e shërbimeve të sektorëve si: mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike, sport e rekreacion, duke u ofruar fëmijëve të komunës sonë kushtet më të mira të mundshme dhe duke e mbështetur zhvillimin e plotë të potencialit të tyre. Në sektorët përkatës do të identifikohen nevojat specifike dhe llojet e shërbimeve bazë të cilat duhet të përmirësohen si dhe ofrimi i shërbimeve shtesë. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet kategorive me të cënueshme të fëmijëve siç janë: fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga familjet që janë përfitues të skemës së ndihmës sociale, fëmijët lëmoshë kërkues apo fëmijët në nevojë për mbrojtje, fëmijët e komuniteteve.

Krahas ofrimit të shërbimeve për fëmijë, do të ofrohet mbështetje për familjet dhe komunitetin përmes edukimit, sikurse edhe do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve të fushave të ndryshme që ta përmirësojnë cilësinë e shërbimeve që ofrojnë.

1.1 Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë

Do të krijohet një sistem për të mbajtur publikun të informuar për të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë. Fillimisht do të bëhet evidentimi i të gjitha shërbimeve ndaj fëmijëve. Më tutje do të zhvillohet një katalog i llojeve të shërbimeve sociale që ofrohen dhe i ofruesve të shërbimeve si dhe të drejtat e qytetarëve që të kenë qasje në këto shërbime. Do të organizohet një fushatë sensibilizuese për të rritur vetëdijen e qytetarëve përmes institucioneve publike, mediave lokale, ueb faqes së komunës dhe kanaleve tjera të komunikimit.

1.2 Rritja e fondit për fëmijë në nevojë për mbrojtje

Fëmijët në nevojë për mbrojtje kanë nevojë për përkrahje emergjente institucionale në kuptim të ofrimit të shërbimeve profesionale ndërsektoriale, por edhe ofrimit të shërbimeve logjistike, siç janë ushqimi, transporti, akomodimi, etj. Për këtë arsye do të bëhet rritja e fondeve për këta fëmijë dhe do të krijohet një sistem unifikues ndërsektorial për menaxhimin e këtij financimi dhe këtyre shërbimeve emergjente. Do të evidentohen nevojat për shërbime emergjente dhe do të kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

1.3 Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve strehuese dhe farefisnore

Koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore është provuar si i suksesshëm, prandaj edhe është i paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Të punohet në promovimin dhe ofrimin e shërbimit për strehimin e fëmijëve në familje strehuese, si dhe të mbështyeten familjet strehuese farefisnore. Aktualisht nuk kemi familje strehuese dhe një ndër objektivat kryesore të drejtorisë së Mirëqenies Sociale është themelimi ishërbimit përkatës, të parashihen politika për subvencionimin e familjeve strehuese dhe atyre farefisnore.

1.4 Programe për prindër në prindërimin e përditshëm dhe disiplinën pozitive

Organizimin e trajnimeve me prindër në prindërimin e përditshëm sipas moduleve ekzistuese të prindërimit të mirë do të përshtaten për nevoja të komunitetit. Duke krijuar kapacitete njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit dhe do të shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve e sesioneve të informimit me psikolog e pedagog të shkollës që me pas këta të ofrojnë këto sesione për prindërit e shkollës së tyre.

1.5 Ofrimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për tu regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën

Arsimi i obligueshëm nënkupton që çdo fëmijë i moshës shkollore ta vijojë shkollimin, edhe pse komuna jonë ballafaqohet me raste të mosregjistrimit, mosvijimit të rregullt dhe braktisjes së shkollimit. Do të fuqizohet komunikimi mes shkollave dhe zyrave të regjistrimit civil dhe mundësit për krijimin e një sistemi për t'i marrë të dhënat e fëmijëve të moshës shkollore nga zona që gravitojnë shkollat, në mënyrë që të lehtësohet procesi i regjistrimit në shkollë. Shkollat do të obligohen që të mirëmbajnë dhe përditësojnë me informata të nevojshme bazën e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA). Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) do të krijohen në të gjitha shkollat si dhe do të bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithë përfshirjes në arsim. Drejtoria e Mirëqenies sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Qendrën për Punë Sociale, organizatat të ndryshme aty ku kemi informata që ata fëmijë nuk po ju qasen apo nuk vijnë procesin mësimor shkaku i kushteve ekonomike mundohemi që ti përkrahim me mjete shkollore në mënyrë që ata fëmijë të ju kthehen bankave shkollore.

1.6 Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla

Do të trajnohen mësimdhënësit për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike, logopedike dhe psikosociale si dhe krijohet/funksionalizohen mekanizma për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale. Po ashtu do të identifikohen nevojat për mësimdhënësit mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe do të angazhohen këta mësimdhënësit në secilën shkollë të komunës sonë.

Duke respektuar këtë të drejtë DKA në Kamenicë , ka ndërmarrë të gjitha hapat për të ofruar shërbime për këtë kategori të fëmijëve në çerdhe-kopshte si dhe në shkolla.

1.7 Inspektimi i cilësisë së hapësirave dhe pajisjeve shkollore

Gjendja e objekteve shkollore ndikon shumë në cilësinë e arsimit. Prandaj, ekipet profesionale do ta inspektojnë gjendjen e shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj). Këto ekipe do të inspektojnë objektet shkollore në baza vjetore dhe do të dalin me raporte vlerësuese. Mbështetur në të dalurat e raporteve do të ndërmerren masa për investim me qëllim të krijimit të objekteve dhe mjediseve shkollore miqësore e të sigurta për fëmijë. Vazhdimisht do të promovohen standardet e shkollave të sigurta e mike për fëmijë .

1.8 Promovimi shëndetësor dhe i të ushqyerit shëndetshëm

Do të promovohet shëndeti përmes fushatës vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe përmes edukimit shëndetësor të qytetarëve e ligjëratave për edukimin shëndetësor dhe reprodutiv për nxënësit e shkollave. Po ashtu, do të organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca narkotike.

1.9 Organizimi i vizitave multidisciplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike

Në bashkëpunim me organizatat vendore e ndërkombëtare do t'i kushtohet kujdes ofrimit të shërbimeve të individualizuara shëndetësore për secilin fëmijë. Prandaj do të zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe përkrahje të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Do të organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, të cilat do të kenë përveç komponentit të intervenimit shëndetësor edhe atë edukativ. Do të zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal dhe vizitave për nënat dhe fëmijët. Kontrollat sistematike shëndetësore do të realizohen edhe nëpër shkolla.

1.10 Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevoja të veçanta

Do të krijohet dhe përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta. Do të promovohen shërbimet institucionale dhe ato të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijë me nevoja të veçanta. Do të hartohet dhe përdoret një formular për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës së tij/saj, gjatë regjistrimit në shkollë. Për ata fëmijë që kanë parametra që identifikojnë nevojën për kontroll më të hollësishëm, do të ndërmerren vlerësime dhe do të rekomandohen masa që duhet ndërmarrë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, psikologu/ja, prindërit). Po ashtu një data-bazë e fëmijëve në institucionet parashkollore me nevojat e ofrimit të shërbimeve logopedike është bërë dhe do realizohen fushata me prindër.

1.11 Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë

Do të ofrohen shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim i bazuar në bashkësi për fëmijët me nevoja të veçanta, përmes subvencionimit të organizatave të licencuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Do të krijohen kushte dhe mundësi për qasje fizike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësirat publike duke i paraprirë me identifikimin e nevojave për intervenime në qasjen fizike. Po ashtu do të ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cenueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmoshëkërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët viktime të trafikimit, etj.). Programe të tilla do të jenë mësimi shtesë përmes qendrave mësimore në komunitet, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.

1.12 Hapja e një Qendre Ditore për fëmijët me nevoja të veçanta:

Gjatë vitit 2024-2026 planifikojmë të hapim një Qendër Ditore për fëmijët me nevoja të veçanta, e cila është shumë e nevojshme dhe ne vazhdimisht e kemi paraqitur si nevojë të komunitetit tonë në takime të ndryshme. Ç'do fëmijë meriton të ketë trajtim dhe kushte për të mësuar dhe aftësuar pa dallime dhe në komunën tonë një Qendër e tillë mungon. Përmes kësaj Qendre do të ofrojmë shërbime edukative, sociale, logopedike, psikologjike, si dhe do të zhvillohen aktivitete të ndryshme nga personat e trajnuar dhe të licencuar në këtë Qendër.

OBJEKTIVI 2: Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve

Ne do të punojmë dhe angazhohemi vazhdimisht që në bashkëpunim me partnerët tanë, të krijojmë një sistem efektiv për të vetëdijësuar të rriturit, por edhe vet fëmijët për të drejtat e fëmijëve, mirëqenien e tyre dhe krijimin e një komune mike për ta. Programet për informim dhe zhvillim profesional për të gjitha palët duke përfshirë edhe politikëbërësit e zyrtarët më të lartë komunalë, janë të një rëndësie të veçantë. Në të njëjtën kohë, ne do t'i inkurajojmë organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e pavarura që të avokojnë për fëmijët dhe me fëmijët. Mediat lokale elektronike, ueb faqet dhe rrjetet sociale do të shfrytëzohen në promovimin e vazhdueshëm të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje aty ku preket interesi më i mirë i tyre.

2.1 Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve.

Ngritja e njohurive mbi të drejtat e fëmijës është e rëndësishme për të ndërgjegjësuar dhe përgatitur ata për të kuptuar dhe zbatuar me efikasitet politikat dhe veprimet që kanë ndikim në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve. Prandaj, do të organizohen trajnime për ta në temat e njohjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, instrumenteve ndërkombëtare, legjislacionit dhe rregullativës që lidhet me të drejtat e fëmijëve, vlerësimit dhe raportimit të gjendjes së fëmijëve, standardeve të operimit, investimit publik në fëmijë, etj. Këto trajnime mund të ndihmojnë në përmirësimin e qëllimeve dhe strategjive të qeverive vendore për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

2.2 Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët

Qytetarët duhet të vetëdijësohen për atributet e komunës mike për fëmijë dhe të aktivizohen si qytetarë të përgjegjshëm, përmes zhvillimit të fushatave dhe kampanjave vetëdijesuese për të rritur dhe fëmijë. Fushatat do të përfshijnë ligjëratat publike, shpërndarjen e materialit promovues, emisione në TV e radio, mesazhe promovuese përmes rrjeteve sociale etj.

2.3 Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës

Ne do të mbështesim dhe do të jemi aktiv në aktivitet avokuese që realizohen nga organizatat joqeveritare, koalicionet e rrjetet që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Do të përkrahet puna e tyre dhe do të mundësohet e përkrahet puna e vetë organizatave të fëmijëve dhe të rinjve apo që punojnë me këto kategori në avokimin për të drejtat e tyre. Do t'i subvencionojmë organizatat të cilat merren me këto kategori dhe ti mbështesim projektet e tyre , ku përmes këtyre projekteve do të kontribuojnë në ngritjen e mirëqenies së jetës së fëmijëve në komunën tonë.

2.4 Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias

Mediat do të jenë një ndër mekanizmat shumë me rëndësi në promovimin e të drejtave të fëmijëve, për të publikuar lajme dhe storie në interesin më të mirë të tyre, ku do të ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyrën e informimit dhe marrëdhëniet me publikun, për sekretariatit e ekipit si dhe për mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike në komunën tonë. Mediat dhe organizatat që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve apo ofrojnë shërbime për fëmijë do të trajtohen si partnere dhe përkrahen që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale.

OBJEKTIVI 3: Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët

Ne, do të angazhohemi që të gjitha hapësirat publike ku frekuentojnë fëmijët e komunës sonë të jenë plotësisht të parrezikshme për ta dhe t'u krijojnë atyre ndjenjën e sigurisë në çdo kohë, edhe atëherë kur janë vetëm. Fëmijët dhe prindërit do të përfshihen aktivisht në konsultime gjatë rregullimeve urbanistike, higjienës kolektive, do të krijojnë kushte për lëvizje të lirë e të qasshme në trotuare dhe siguri në trafik.

3.1 Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët

Komuna jonë vazhdimisht është e angazhuar të punojnë në krijimin e hapësirave të duhura të trafikut, pasi që përballemi më një trafik të ngarkuar nga numri i madh i makinave dhe hapësira për parkingje të pamjaftueshme se dhe të zhvillohen trotuare apo shtigje shtesë për këmbësorë e biçiklista. Nga kjo situatë me se shumti atakohen fëmijët e komunës sonë dhe për të këtë situatë, do të hartohen dhe zbatohen projekte për lirim të trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve dhe pjerrina, vendosjen e barrierave (polic të shtrirë), shtigjeve të biçiklistëve, etj. Të sigurohet hapësira brenda në oborrin e shkollave për mjetin e transportit të nxënësve të kontraktuar nga Drejtoria e Arsimit. Po ashtu Drejtoria e Arsimit planifikon që shumë shpejt do të sigurojmë transportin për të gjithë nxënësit e shkollimit obligativ. Drejtoria e Arsimit së bashku më menaxherët e shkollave do të nxjerrin vendim që asnjë makinë e prindërve të mos futet në hapësirat e brendshme të shkollës.

3.2 Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik

Duke vlerësuar rreziqet në hapësirat publike në afërsi të shkollave ku kemi numrin më të madh të fëmijëve do të merren masa për të parandaluar rreziqet e mundshme përreth shkollës, që mund të vijnë nga prania e personave të dyshimtë, shitja e artikujve të dëmshëm si dhe qentë endacak. Për të rritur vetëdijen e ruajtjes së mjedisit dhe ndikimi në shëndetin tonë do të ndërtohet hapësira të reja gjelbëruese në qytet në disa lokacione si dhe disa fshatra ku frekuentohen nga fëmijët që të krijohen parqe që mund të shfrytëzohen nga fëmijët.

OBJEKTIVI 4: Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit

Zhvillimi i fëmijëve dhe talentin që kanë përmes një segmenti shumë të rëndësishëm si janë loja, rekreacioni dhe sporti janë elemente të rëndësishme ku ata shfaqin talentet e tyre. Do të promovohet pjesëmarrja e fëmijëve nëpër klube sportive e institucione kulturore dhe shkolla, pasi që shkollat do të krijojnë lidhjet me klubet sportive, klubet artistike e kulturore, në mënyrë që fëmijët të mund t'i zhvillojnë më tutje talentet e tyre në fushat në të cilat kanë interesim. Hapësirat publike do të adaptohen që të sigurojnë argëtim e kohë të lirë për fëmijët nëpër lagje.

4.1 Promovimi i sportit dhe krijimi i klubeve në shkolla

Në shkollat e komunës sonë rëndësi do të i kushtohet promovimit të sportit dhe së bashku me shkollën dhe klubet sportive do të krijohen edhe klubet sportive në nivel të shkollave dhe do të organizohen gara e ekspozita shkollore në sporte të ndryshme. Gjatë promovimit të sportit dhe zhvillimit të garave rëndësi do t'i kushtohet përfshirjes gjinore dhe thyerjes së stereotipive gjinore në fushën e sportit pasi që komuna jonë njihet edhe për klube sportive në kategorinë e femrave dhe jo vetëm meshkujve.

4.3 Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë

Programe artistike e kulturore do të organizohen nëpër shkolla, ku fëmijët do të demonstrojnë shkathtësitë e tyre duke i ndërlidh edhe me shoqatat kulturore e artistike si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, ekspozita me punime artistike të nxënësve të shkollave fillore etj. Do të përkrahen shkollat dhe institucionet në promovimin e hapësirave për teknologji informative dhe IT në programim, kodim, ueb dizajn, etj.

4.4 Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion

Ne do angazhohemi që të intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja në ato lagje e fshatra ku është e mundur krijimi i hapësirave të tilla. Ë gjithë kjo do të bëhet në përputhje me standardet e hapësirave të sigurtë e mike për fëmijë. Do të krijohet një partneritet mes komunës dhe komunitetit apo organizatave joqeveritare që ofrojnë aktivitete joformale e rekreative duke krijuar ekipet e përbashkëta për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave rekreative. Për t'i kthyer këto hapësira komunitare në hapësira përfshirëse, do të bëhet identifikimi i nevojave për rekreacion i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në parqet ekzistuese.

4.5 Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin

Po aq me rëndësi është që fëmijëve t'u ofrohen mundësi që këtë kohë rekreacioni ta shfrytëzojnë për aktivitete që janë me përfitim për komunitetin. Kësisoj ata i zhvillojnë vlerat qytetare dhe përgjegjësinë për komunitetin. Komuna do të përkrah organizimin e kampeve me fëmijë dhe të rinj nga shkollat e ndryshme, por edhe atyre nga organizatat e fëmijëve. Këto kampe do të jenë të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. Do të organizohen vizita e takime edukative e kulturore në institucionet që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Më tutje, do të bëhet angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete në përfitim të komunitetit si mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik, etj.

OBJEKTIVI 5: Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre

Ne duam që fëmijët, në varësi të kapacitetit të tyre, të marrin pjesë aktivisht në vendimet për komunën, sidomos në ato që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Do të ndihmojmë edhe familjet që të ndjekin këtë qasje që nga fëmijëria e hershme, kurdo që vendoset për jetët e fëmijëve të tyre. Institucionet arsimore kanë një rol të madh në fuqizimin e fëmijëve në pjesëmarrje. Strukturave përfaqësuese të fëmijëve në nivele të ndryshme do t'u ofrohet hapësirë veprimi dhe përkrahje nga të rriturit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre. Organet vendimmarrëse në të gjithë sektorët e komunës do të ndjekin procedurat e konsultimeve me fëmijë para se të marrin vendime që ndikojnë në jetën e fëmijëve.

5.1 Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes

Do të përcaktohen procedurat për konsultimin e fëmijëve për të gjitha palët në komunë që marrin vendime për fëmijët dhe në përgjithësi për qytetarët e komunës. Këto procedura do të paraqiten përmes një udhëzuesi praktik. Do të monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë nga të gjithë sektorët komunalë me rastet e hartimit të projekteve zhvillimore, strategjive e planeve të veprimit, me rastin e planifikimit të buxhetit, etj.

5.2 Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve

Këshillat e nxënësve janë organe të nxënësve të parapara me ligj. Ndonëse ato janë të themeluara në të gjitha shkollat, funksionimi i tyre duke përfshirë mënyrën e përzgjedhjes dhe mandatin e angazhimit të tyre është larg prej standardeve të përfaqësimit demokratik. Prandaj, do të nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet, duke filluar nga këshillat e nxënësve nëpër klasa, e deri te Asambleja Komunale e Fëmijëve. Këto organe duhet të jenë gjithëpërfshirëse në kuptim të përfaqësimit gjinor, gjeografik, etnik, të aftësive, etj. Më tutje, do të zhvillohen kapacitetet e fëmijëve për pjesëmarrje demokratike në jetën shkollore dhe të komunitetit, përmes moduleve të trajnimit për udhëheqje e aktivizim qytetar. Një aspekt qenësor është rregullimi i marrëdhënieve në mes vetë nxënësve. Për këtë arsye do të promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë, por edhe në lagje. Do të identifikohen fëmijë që mund të angazhohen si ndërmjetësues dhe të trajnohen për aspekte të ndërmjetësimit në mes moshatarëve.

OBJEKTIVI 6: Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë

Ne duam që i gjithë procesi i zbatimit të planit të punës të reflektojë qeverisjen e mirë dhe miqësore për fëmijë. Prandaj, është me shumë rëndësi që ky proces të jetë me pronësi të gjerë, ku të gjitha palët do të bashkërendojnë veprimet me qëllimin që të adresohen masat e definuara me planin e punës. Ndërsa, për të siguruar cilësinë në nevojitet zhvillimi i instrumenteve për vlerësimin e ndikimit në fëmijë, dhe hartimi i raporteve për gjendjen e fëmijëve të komunës.

6.1 Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve

I gjithë procesi i qeverisjes miqësore për fëmijë, i bashkërenduar përmes planit të punës ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit që ka në fëmijë. Prandaj, fillimisht do të realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimit të planit të punës. Pastaj, do të bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës. Raportet nga vlerësimi do të diskutohen në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikatat e qeverisjes lokale.

6.2 Koordinimi me palët relevante

Qasja e bashkëpunimit me të gjitha palët, është parim i punës së qeverisjes komunale në përpjekjen për një komunë mike për fëmijë. Prandaj, do të mbajmë komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me palët e ndryshme si në nivelin lokal (me organizata, grupe joformale, bashkësi lokale, këshilla, etj.), ashtu edhe në nivelin rajonal e qendror (me institucionet qendrore/rajonale që ofrojnë shërbime në nivel komunal, por edhe me vetë qeverisjen qendrore) Kjo do të na ndihmojë që të sigurojmë politika të mira për fëmijët, si dhe të kërkojmë përkrahje shtesë nga niveli qendror për nevojat e fëmijëve të komunës.

6.3 Vlerësimi dhe raportimi

Plani i veprimit do t'i nënshtrohet vlerësimit periodik në baza gjashtëmuajshe, prej nga do të nxjerrën raportet, të cilat do të shërbejnë për periudhat vijuese të implementimit. Ndërsa në fund të periudhës së zbatimit të planit trevjeçar do të bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të këtij plani dhe do të hartohet raporti i cili do të shërbejë si burim për planifikimin e planit të ardhshëm disavjeçar.

PLANI I VEPRIMIT

0	Objektiva strategjike	
0.0	Masa	
	Veprimi	
1	Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë	
1.1	Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë	
	Bëhet ekzaminimi/evidentimi i shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë	
	Zhvillohet katalogu i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve	
	Organizohet fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale dhe ueb faqes së komunës	
1.2	Rritja e fondit për fëmijët në nevojë për mbrojtje	
	Identifikohen nevojat për shërbime	
	Kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët (si: mallra, ushqim, transport, etj.)	
1.3	Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv	
	Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit.	
	Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnereve), p.sh. psikologët në shkollë, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj.	
	Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informuese	
1.4	Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për ta regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën	
	Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijët e moshës shkollore të zonës	
	Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale	

	Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s
	Funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) në komune dhe shkolla
	Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim
1.5	Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla
	Trajnohen mësime dhënëse për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike logopedike dhe psikosociale
	Krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale, sipas politikës për mbrojtjen e fëmijës
	Identifikohen nevojat për mësime dhënëse mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara
	Punësohen mësime dhënësit mbështetëse
1.6	Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore
	Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të gjendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj.)
	Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte
	Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet
	Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë
1.7	Krijimi i mekanizmave brenda shkollave për mirëmbajtje të mjediseve shkollore
	Vetëdijësohen nxënësit dhe palët tjera për nevojën e mirëmbajtjes së shkollës
	Hartohet udhëzues me praktika të mira të mirëmbajtjes së hapësirave shkollore
	Shpërblehen komunitetet më të veshme shkollore
1.8	Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit
	Ndërmerret fushatë vetëdijësuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave me qumësht gjiri, ushqimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe adoleshentëve
	Organizohen ligjërata për edukimin shëndetësor dhe riprodktiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjëratave të profesionistëve shëndetësorë

	Organizohen ligjërata për parandalimin e abuzimit me substanca	
1.9	Organizimi i vizitave multidisciplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike	
	Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.	
	Realizimi i vizitave shëndetësore në shtëpi për nënën dhe fëmijët	
	Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal	
	Realizohen kontrollet sistematike shëndetësore nëpër shkolla	
1.10	Identifikimi i hershëm i fëmijëve me aftësi të kufizuara	
	Perditësimi dhe kategorizimi i bazës së të dhënave për fëmijë me aftësi të kufizuara	
	Promovohen shërbimet institucionale dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijëve me aftësi të kufizuara, me fokus në përfitimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve	
	Zbatohet qarkorja MASHTI/formulari për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë	
	Realizimi i vlerësimit të nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga komisioni komunal për vlerësim, rekomandohen masat që duhet ndërmarre shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prinderit)	
1.11	Ofrimi i shërbimeve profesionale për mbrojtjen e fëmijës në nevojë	
	Subvencionohen organizatat e licencuara për fëmijët me aftësi të kufizuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi	
	Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësira dhe institucione publike	
	Ofrohen programe mbështetëse për fëmijët nga grupet e cënueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëmoshë kërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikuar, etj.), të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitete rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.	
	Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendrës për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimit, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj.) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë	

2	Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve
2.1	Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunal për të drejtat e fëmijës dhe mekanizmave komunal për të drejtat e fëmijës
	Ofrohen trajnimet për politikëbërësit dhe zyrtarët komunal në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës
2.2	Organizimi i fushatave vetëdijesuese për opinionin e gjerë për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës
2.3	Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura për avokim për të drejtat e fëmijës
	Përkrahja e organizatave joqeveritare, koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve
	Përkrahja e mekanizmave të fëmijëve dhe të rinjve
2.4	Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias
	Ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyren komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike
	Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale
	Organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve
3	Krijimi i hapësirave publike të sigurt dhe miqësore për fëmijët
3.1	Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët
	Hartohen dhe realizohen projekte për lirimin e trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, sinjalizimi i shtigjeve të biçiklistëve etj.
	Bëhet fushatë informimi me të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik.
3.2	Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik
	Promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër.

	Menaxhohen/sistemohen qentë endacakë	
	Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkollës (personat e paautorizuar, shitja e artikujve të dëmshëm, etj.)	
	Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.	
4	Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit	
4.1	Promovimi i sportit nëpër shkolla	
	Ngriten kapacitetet e përfaqësuesve të shkollave për promovimin e sportit shkollior	
	Krijohen/zhvillohen klubet sportive shkollore	
	Organizohen gara sportive mes shkollave	
4.2	Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja	
	Nxitet rekrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive	
	Mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve	
	Organizohen kampe për identifikimin e talentëve në sporte	
4.3	Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë	
	Nxitet themelimi/funksionimi i klubeve artistike e kulturore nëpër shkolla	
	Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të organizatave të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj.	
	Ofrohen më shumë hapësira nëpër shkolla e gjetiu që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike si: programim, kodim, ueb dizajn, etj.	
4.4	Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion	
	Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë	
	Intervenohet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja	
	Krijohen ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative	
4.5	Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin	

	Organizohen kampe të natyrës rekreative, edukative, mjedisore, etj. për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve
	Organizohen vizita e takime në institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve
	Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik)
5	Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre
5.1	Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes
	Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vendimmarrëse
	Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë
5.2	Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve
	Nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet
	Trajnohen përfaqësuesit e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar
	Promovohet ndërmjetësimi në mes moshatarëve si qasje për të adresuar problemet, konfliktet, ngacmimet e dhunën në shkollë
6	Bashkërendimi i veprimeve të të gjitha palëve përmes procesit të koordinimit, si dhe përmes vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e fëmijëve në komunë
6.1	Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve
	Realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimi të planit të punës
	Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës
	Diskutohen raportet në nivel të ekipit komunal dhe po ashtu përfshihen në politikat dhe praktikat të qeverisjes lokale
6.2	Koordinimi me palët relevante
	Mbahet komunikim e bashkëpunim sipas nevojës me palët e tjera në nivel qendror, lokal dhe në nivel të komunitetit

6.3	Vlerësimi dhe raportimi
	Behet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti
	Behet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti përfundimtar

SHTOJCA: PLANI I DETAJUAR I VEPRIMIT

Plani i detajuar i veprimit (me bartësit, shtrirjen kohore, nevojat buxhetore dhe burimet e financimit) është dhënë si shtojcë në një dokument Exceli

**EKIPË KOMUNAL PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, PEJË
PLANI TRËVËÇAR I PUNËS**

Nr.	Objektivat strategjike/masat/veprimet	Treguesit e suksesit	Barësht	Nevojat buxhetore
1	Ofrimi i shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijët në komunë			
1.1	Krijimi i një sistemi informues shumëdimensional për llojet e shërbimeve sociale në komunë			
	Bëhet ekzaminimi/evidentimi i shërbimeve ndaj fëmijëve në Komunë		Drejtoria për mirëqenie sociale	
	Zhvillohet katalogu i llojeve të shërbimeve komunale dhe ofruesve të shërbimeve	Publiku është i informuar për gamën e shërbimeve për fëmijët në komunë	Drejtoria për mirëqenie sociale/sekretariati	€2,000.00
	Organizohet një fushatë informuese përmes institucioneve publike, medias lokale dhe ueb faqes së komunës		Kryesuesi i ekipit/Zyra për informim	
1.2	Ndarja e fondit për fëmijët në rrethana të jashtëzakonshme			
	Identifikohen nevojat për shërbime		Drejtoria për mirëqenie sociale/QPS	
	Kontraktohen operatorët ekonomikë për ofrimin e shërbimeve emergjente për fëmijët (si: mallëra, ushqim, transport, etj.)	Kontratat kornizë për shërbime emergjente janë të lidhura	Zyra e prokurimit	€5,000.00
1.3	Fuqizimi i konceptit të familjeve strehuese dhe farefisnore			
	Promovohet koncepti i familjeve strehuese dhe farefisnore		DMS	€1,000.00
	Bëhet identifikimi dhe vlerësimi i familjeve strehuese dhe farefisnore	Së paku tri familje strehuese brenda komunës	DMS	
	Trajnohen familjet strehuese dhe farefisnore		DMS	€500.00
	Ofrohet strehimi dhe monitorohet trajtimi i fëmijëve brenda këtyre familjeve		DMS/QPS	€15,000.00
1.4	Zhvillimi i praktikave të prindërimit të mirë dhe disiplinimit pozitiv			
	Përshtaten modulet/praktikat ekzistuese të prindërimit të mirë për nevoja të komunitetit.	Së paku 30 trajnerë të certifikuar	DKA/DSH	

	Krijohen kapacitetet njerëzore për ofrimin e moduleve të trajnimit (trajnim i trajnerëve), p.sh. psikologët në shkolla, edukatorët, profesionistët shëndetësorë, etj.	Së paku 500 prindër përfitues të trajnimeve/sesioneve informuese	DKA/DSH	€6,000.00
	Shpërndahen praktikat e prindërimit të mirë përmes trajnimeve/sesioneve informuese		DKA/DSH	€1,500.00
1.5	Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar, vijuar dhe përfunduar shkollën			
	Bashkëpunohet me zyrën e regjistrimit civil dhe merren informata për të gjithë fëmijëve të moshës shkollore të zonës.	Të gjithë fëmijët e moshës shkollore janë regjistruar në shkollë;	Drejtoria e Administratës	
	Regjistrohen nxënësit duke respektuar rregulloren komunale.		DKA	
	Mirëmbahet baza e të dhënave me të dhëna për nxënësit sipas modelit SMIA-s	Rastet e rrezikut nga braktisja dhe të braktisjes adresohen me efikasitet	DKA/Shkollat	
	Funksionalizohen Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM)		DKA/Shkollat	
	Bashkëpunohet ngushtë me organizatat që punojnë në fushën e gjuhëpërfshirjes në arsim		DKA	
1.6	Ofrimi i shërbimeve profesionale nëpër shkolla			
	Trajnohen mësimdhënës për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale pedagogjike dhe psikosociale	Mekanizëm efektiv i referimit të fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale;	DKA	
	Krijohet/funksionalizohet mekanizmi për referimin e fëmijëve në nevojë për shërbime profesionale	Numër i shtuar i mësimdhënësve mbështetës	DKA/Shkollat	
	Identifikohen nevojat për mësimdhënës mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara		DKA/MASHTI	
	Punësohen mësimdhënësit mbështetës		DKA/MASHTI	
1.7	Inspektimi i cilësisë së hapësirave shkollore			
	Angazhohen ekipe profesionale për inspektim të glendjes së shkollave (inspektim të vjetërsisë së objekteve, sanitarisë, hapësirave për lojë e rekreacion, pajisjeve shkollore, etj.)			
	Inspektohen objektet shkollore në baza vjetore dhe hartohen raporte	Shkollat i plotësojnë standardet e shkollave mike për fëmijë	DKA	
	Ndërmerren masa përmirësuese bazuar në raportet		DKA	
	Promovohen standardet për shkollat mike për fëmijë		DKA	

1.8	Promovimi shëndetësor, përmes informimit, komunikimit dhe edukimit.				
	Ndërmerret fushatë vetëdijesuese për shëndetin dhe të ushqyerit e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve	DSH/QMF - ISHP			€1.000.00
	Organizohen ligjëratat për edukimin shëndetësor dhe riproduktiv për nxënësit e shkollave, përmes sistemit të ligjëratave të profesionistëve shëndetësorë.	DSH/QMF - ISHP			
	Organizohen ligjëratat për parandalimin e abuzimit me substanca	DSH/QMF - ISHP - Policia e Kosovës			
1.90	Organizimi i vizitave multidisciplinare shëndetësore për fëmijët, në baza periodike				
	Zhvillohen kapacitetet e profesionistëve shëndetësorë për kujdes shëndetësor ndaj nënës dhe fëmijës, për këshillim për të ushqyerit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël dhe për përkrahjen e zhvillimit në fëmijërinë e hershme.				
	Organizohen vizita shëndetësore në shtëpi për nënat dhe fëmijët	QMF			
	Zbatohen praktikat efektive të kujdesit perinatal	QMF			
	Organizohet shërbimi i vizitave sistematike nëpër shtëpi, me komponentin e intervenimit shëndetësor edhe atij edukativ.	QMF			
	Realizohen kontrollat sistematike shëndetësore nëpër shkolla	QMF			
1.11	Identifikimi i hershëm i fëmijëve me nevojë të veçanta	QMF/ISHP			
	Përditësohet baza e të dhënave për fëmijët me nevojë të veçanta				
	Promovohen shërbimet institucionale dhe të ofruesve të tjerë të shërbimeve për fëmijëve me nevojë të veçanta, me fokus në përfitimet e FNV dhe familjeve	DMS			€6.000.00
	Hartohet/përdoret dokumenti (formulari) për deklarimin e prindit për gjendjen shëndetësore të fëmijës, gjatë regjistrimit në shkollë.	DMS			
	bëhen vlerësime të fëmijëve në nevojë dhe rekomandohen masat që duhet ndërmarë shkolla (mësimdhënësit, menaxhmenti i shkollës, prindërit)	DKA			
1.12	Ofrimi i shërbimeve të veçanta për kategoritë e fëmijëve në nevojë	DKA/Ekipi vlerësues			

	Subvencionohen organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime shumëdimensionale dhe rehabilitim të bazuar në bashkësi, për fëmijët me aftësi të kufizuara	Identifikohen nevojat dhe sigurohet qasja fizike e fëmijëve me aftësi të kufizuara në hapësira publike	Ofrohen programe të mbështetjes shtesë për fëmijët nga grupet e cënueshme (komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët në situatë rruge/lëshohërkuesit, fëmijët që punojnë, fëmijët e trafikuar, etj.), të tilla si mësimi shtesë përmes qendrave mësimore, përfshirja në aktivitetet rekreative të qendrave rinore, sesione këshillimi, etj.	Avancohet komunikimi ndërmjet palëve kryesore (Qendres për Punë Sociale, Kujdesit Parësor Shëndetësor, Personelit Arsimor, Policisë, Gjykatës, Organizatave Joqeveritare, etj) për një referim dhe kujdes ndaj fëmijëve në nevojë	Zbatimi i programeve të vetdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve		Së paku 100 janë përfutur të shërbimeve rehabilituese Treguesi për eliminimin e barrierave (ne varesi te planit) Ekzistojnë dhe zbatohen programe të vecanta të mbështetjes për kategori të fëmijëve nga grupet e cënueshme	DMS DSHP/DUIMM DMS/DKRS/ZKKK Treguat për menaxhimin e rasteve	€180,000.00 €15,000.00 €9,000.00
2	Ngritja e kapaciteteve të politikëbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve	Ofrohen trajnimet për politikëbërësit dhe zyrtarët komunalë në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës	Organizimi i fushatave vetdijesuese për të riturit dhe për fëmijët	Planifikohen dhe organizohen fushatat vetdijesuese dhe shpërndahet material promovues për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre	Mbi 80% e zyrtarëve komunalë janë të trajnuar për aspekte të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës	ZBGJDNJ			€3,000.00
2.2	Mbështetja e organizatave joqeveritare dhe institucioneve të pavarura në avokimin për të drejtat e fëmijës	Përkrahet puna e organizatave joqeveritare, koalicioneve e rrjeteve që monitorojnë, promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve	Mundësohet dhe përkrahet puna e vetë strukturave organizative të fëmijëve dhe të rinjëve	Promovimi i të drejtave të fëmijës përmes medias	OJQ-të dhe institucionet e pavarura rregullisht mbështeten nga komuna në avokimin për fëmijët	ZBGJDNJ/Zyra e Informimit Kabineti I Kryetarit Kabineti i kryetarit/DKRS			€3,000.00 €12,000.00 €6,000.00

	Ofrohen udhëzues dhe trajnime për zyrën komunale për marrëdhënie me publikun, për sekretariatit e Ekipit dhe mediat e profesionistët e mediave të shkruara dhe elektronike. Përkrahen mediat që të promovojnë të drejtat e fëmijëve dhe që të paraqesin gjendjen e fëmijëve në mënyrë transparente e reale. Organizohen forume diskutimi në mes komunës dhe mediave lidhur me standardet për mbrojtjen e identitetit dhe integritetit të fëmijëve.	Zyrtarët e komunës përgjegjës për komunikim me publikun janë kompetentë në çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve; Komuna ka subvencionuar fushatat mediale në promovim të të drejtave të fëmijës	Kabineti i kryetarit Kabineti i kryetarit Kabineti i kryetarit	€1,500.00
3	Krijimi i hapësirave publike të sigurta dhe miqësore për fëmijët			
3.1	Sigurimi i sistemit të trafikut që është i sigurt dhe miqësor për fëmijët			
	Hartohen dhe realizohen projekte për lirin e trotuaresve dhe vendkalimeve për këmbësorë, vendosjen e shenjave të vendkalimeve, vendosjen e barrierave, shjalizimi i shtigjeve të bigiklistëve etj. Bëhet fushatë informimi me të gjithë pjesëmarrësit në trafik për sigurinë në trafik.	Projektet e trafikut të sigurt janë në zbatim të vazhdueshëm	DSHP/Policia Policia	€15,000.00
3.2	Eliminimi i rreziqeve dhe krijimi i mjedisit ekologjik			
	Promovohet linja telefonike për publikun për raportimin e rreziqeve si dhe merren masa për eliminimin e tyre në afat sa më të shkurtër. Menaxhohen/sistemohen qentë endacakë	Drejtoria e shërbimeve publike		
	Merren masa për të parandaluar rreziqet përreth shkolllës (personat e paautorizuar, shitja e artikujeve të dëmshëm, etj.)	Drejtoria e bujqësisë		€40,000.00
	Rritet sipërfaqja e hapësirave të gjelbra e parqeve në qytet, si dhe pyjeve në pjesën rurale.	DKA, policia, Drejtoria e Inspektoratit		
		DUMM		€280,000.00
4	Zhvillimi i fëmijëve përmes sporteve, lojës dhe rekreacionit			
4.1	Promovimi i sportit nëpër shkollë			
	Ngriten kapacitetet e përfaqësuesve të shkollave për promovimin e sportit shkollior	DKRS dhe DKA		€18,000.00

	Krijohen/zhvillohen klubet sportive shkollore	Në të gjitha shkollat së paku disa klube sportive për djem e vajza janë funksionale	DKRS dhe DKA	
	Organizohen gara sportive mes shkollave		DKRS dhe DKA	
4.2	Funksionalizimi i klubeve sportive të kategorive të reja			
	Nxitet rekrutimi i fëmijëve djem e vajza nëpër klube sportive		DKRS	€15,000.00
	Mbështetet komunikimi në mes të klubeve, shkollave dhe prindërve	Prurje të shtuara të grupmoshave të reja në klubet sportive të komunës	DKRS	
	Organizohen kampe për identifikimin e talenteve në sporte		DKRS	€36,000.00
4.3	Promovimi i artit, kulturës dhe teknologjisë			
	Nxitet themelimi/funksionimi i klubeve artistike e kulturore nëpër shkolla		DKRS dhe DKA	
	Organizohen aktivitete të përbashkëta të klubeve artistike e kulturore të shkollave dhe të organizatave të artit e kulturës si teatro, ansamble të këngëve e valleve, klube letrare, etj.	Numër i shtuar i klubeve artistike e kulturore në shkollat e komunës;		
	Ofrohen më shumë hapësira nëpër shkolla e gjetiu që fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë teknologjike si: programim, kodim, ueb dizajn, etj.	Futizohen klubet e nxënësve për kodim nëpër shkolla.	DKRS dhe DKA	€18,000.00
4.4	Ofrimi i hapësirave joformale për rekreacion		DKA	
	Inspektohen parqet ekzistuese dhe identifikohen nevojat për hapësira shtesë për lojë			
	Intervenohehet në adaptimin e hapësirave ekzistuese për lojë dhe në ndërtimin e hapësirave të reja	Numër i shtuar i hapësirave joformale për rekreacion;	DKRS	
	Krijohen ekipet e përbashkëta për mirëmbajtjen e hapësirave rekreative	Së paku 3 ekipe për menaxhim të hapësirave janë funksionale	DKRS	€30,000.00
4.5	Angazhimi i fëmijëve në aktivitete të lira dobiprurëse për komunitetin			
	Organizohen kampe të natyrës, rekreative, edukative, mjedisore, etj. për fëmijët e shkollave dhe organizatave të fëmijëve			
	Organizohen vizita e takime në institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut/fëmijëve	Disa kampe për fëmijë të organizuara;	DKA, OJQ-të	€15,000.00
	Angazhohen fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete në përfitim të komunitetit (mbjellja e drunjëve, ofrimi i ndihmës së parë, evakuimi, siguria në trafik)	Disa aktivitete komunitare me përfshirjen e fëmijëve të organizuara	DKA e ZBGJDNJ	
			DKA, Kryqi i kuq, DUMM, Policia	

5	Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vëzhguese për çështjet që lidhen me jetën e tyre				
5.1	Përfshirja dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes Hapet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vëzhguese Monitorohet zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijë	Në Komunitet gjëritësi zbatohen procedurat e konsultimeve me fëmijë	DMS / Zyrtari për mbrojtjen e fëmijëve Zyrtari për mbrojtjen e fëmijëve	€500.00	
5.2	Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve				
	Nxkitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet	Këshillat e nxënësve në shkollë dhe Asambleja komunale e fëmijëve janë funksionale;	DKA/Zyrtari për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve		
	Trajnohen përfaqësuesit e nxënësve për udhëheqje dhe aktivizim qytetar	Numër i shtuar i ekipeve të nxënësve për ndërmjetësim	DKA	€3,000.00	
6	Bashkëpunimi i veprimeve të të gjitha palëve për procesin të koordinimit, si dhe për vlerësimin dhe raportimin për gjendjen e fëmijëve në komunitet				
6.1	Vlerësimi i ndikimit në fëmijë dhe raportimi për gjendjen e fëmijëve				
	Realizohet një studim bazë lidhur me të gjitha aspektet e qeverisjes, që do të shërbejë për monitorim e vlerësim të zbatimit të planit të punës	Gjendja në fillim të periudhës së planit të veprimit është analizuar përmas një studim fillestar;	Kabineti i Kryetarit/Sekretariatit	€2,000.00	
	Bëhet vlerësimi periodik i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale dhe aspekteve të planit të punës për të drejtat e fëmijës	Raportet e vlerësimit të ndikimit në fëmijë diskutohen në nivel të Ekipit	Kabineti i Kryetarit/Sekretariatit		
6.2	Koordinimi me palët relevante				

